

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm - Divizioni penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatmire Podvorica dhe Bashkëpunëtoren Profesionale Valbonë Fejza, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.M. me vendbanim në P., rr:”...” për shkak të veprës penale Rrezikim i Trafikut Publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.8 par.6 dhe par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.4118/2017 të dt.10.01.2019 pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur më dt.28.02.2019 në praninë e Prokurores së Shtetit – Rukije Sheshivari, të dëmtuarve B.B., V.B., M.M., E.M., L.Zh. dhe të akuzuarit të njejtën ditë në prezencë të palëve mori, publikisht shpalli dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

L.M., nga i ati R. dhe nëna E., mbiemri i vajzërisë së nënës H., i lindur më *data e lindjes...* me vendbanim në P., rr:”...” me numër personal të identifikimit: *numri personal...*, ka të kryer shkollën fillore, i martuar baba i 3 fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike-financiare, sipas evidencës penale të kësaj gjykate i njejtë nuk ka qenë i gjykuar më parë dhe ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar-Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 25.06.2017, rreth orës 13:00 në rrugën magjistrale P.-P. me të arritur në fshatin P., saktësisht afër pllacit të automjeteve (jo-funksionale) “Geti”, i pandehuri L.M. i cili ishte duke e drejtuar automjetin VW Golf, me targa *targat...*, me ngjyrë të kuqe nga pakujdesia ka shkelur rregullat e trafikut rrugor L.nr.05/1-088 dhe atë nenin 53 par.1 ka vënë në rrezik jetën e njerëzve duke vepruar në kundërshtim me dispozitën e cekur më lartë, në atë mënyrë që duke mos i’u përshtatur shpejtësinë e lëvizjes së automjetit kushteve të krijuara në rrugë, ku me të arritur në fshatin P., humb kontrollin mbi automjet, devijon nga rruga në të djathtë ku fillimisht e godet rrethojën e Servisit “Auto Color” dhe pastaj vazhdon drejt duke dëmtuar edhe rrethojën e pllacit të automjeteve të vjetra “Geti” dhe përfundon i rrokullisur mbi automjetet e vjetra (jashtë-funksionale) ku si pasojë e këtij aksidenti zjarri e kaplon automjetin e tij dhe 3 automjete të vjetra dhe si pasojë e aksidentit dëmtime të lehta trupore kanë pësuar V.B., B.B. ndërsa dëmtime të rënda trupore ka pësuar V.B., M.M., E.M. ndërsa si pasojë e lëndimeve trupore të marra nga aksidenti ka ndërruar jetë me datën 07.07.2017 F.(R.) B., gjithashtu lëndime të lehta trupore ka pësuar edhe vet i pandehuri.

Me këtë ka kryer veprën penale Rrezikim i Trafikut Publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.8 par.6 dhe par.1 të KPRK-së.

-Në mbështetje të nenit 77 par.1 dhe 78 par.1 pika 1.1 të KPRK-së,

LIROHET NGA DËNIMI

Meqenëse pasojat e kësaj vepre penale e kanë goditur aq rëndë kryesin, sa që dënimi është i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij.

Gjykata e liron të akuzuarin nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale ngase pagesa e tyre do ta rrezikonte gjendjen materiale të të akuzuarit ose të personave që ai detyrohet ti mbështesë materialisht.

Të dëmtuarit: B.B., V.B. dhe i mituri-V.B. me vendbanim në fshatin L., Komuna e P., M.M. dhe E.M. me vendbanim në P., rr:”...” dhe L.Zh. me vendbanim në fshatin S., Komuna e P. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzë PP.II.nr.4118/2017 të dt.10.01.2019, kundër të akuzuarit L.M. me vendbanim në P., rr:”...” për shkak të veprës penale Rrezikim i Trafikut Publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.8 par.6 dhe par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale Gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 28.02.2019 në të cilën seancë prezentuan prokurorja e shtetit Rukije Sheshivari nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, të dëmtuarit B.B., V.B., M.M., E.M., L.Zh. si dhe i akuzuari L.M.

I akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se: E pranoj fajësinë, rasti më ka ndodhur nga pakujdesia dhe në këtë rast familja ime ka pësuar rëndë sepse si pasojë e aksidentit ka vdekur motra ime F.M.-B. dhe janë lënduar bashkëshortja ime M.M., nëna ime E.M., dhëndrri im B.B., mbesa V.B., nipi V.B. si dhe vet kam pësuar lëndime trupore, nga ai moment kam probleme shëndetsore dhe psiçike sepse pothuaj sa gati nuk e kam shkatërruar gjithë familjen time, ju kërkoj falje të dëmtuarëve por edhe të dëmtuarit-pronarit të lokalit L.Zh., është hera e parë që jam para gjykatës, jam mbajtës i familjes 6 antarëshe dhe meqenëse bashkëshortja ime ka mbetur me pasoja më duhet të kujdesem më shumë, jetojmë vetëm me pensionin e pleqërisë së nënës, lus gjykatën që ti ketë parasysh këto rrethana dhe të më shqiptoj një dënim sa më të lehtë.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

I dëmtuari-B.B. bashkëshorti i të ndjerës në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari deklaroi: I propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë dhe L. M. ta liroj nga dënimi sepse rasti ka ndodhur nga pakujdesia, në këtë rast ka vdekur bashkëshortja ime dhe jemi dëmtuar edhe unë dhe fëmijët e mi sepse kemi qenë me një veturë, lus gjykatën që mos të dënohet L. sepse kemi raporte të mira ndërsa sa i përket kompensimit të dëmit do ta realizoj nga Kompania e Sigurimit, nuk i bashkangjitem ndjekjes penale.

E dëmtuara-V.B. në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari deklaroi: I propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë dhe kërkoj nga gjykata që daja im

mos të dënohet ngase edhe ai e ka humbur motrën në këtë aksident që është nëna ime ndërsa kompensimin e dëmit do ta realizoj përmes Kompanisë së Sigurimit.

I dëmtuari-L.Zh. në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari deklaroi: I propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë, në lokalim tim nuk ka pasur të lënduar por vetëm dëme materiale andaj kompensimin e dëmit do ta realizoj përmes Kompanisë së Sigurimeve.

E dëmtuara-M.M. në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari deklaroi: I propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë ngase i akuzuari është bashkëshorti im, gjykatës i propozoj që ta liroj nga dënimi dhe kompensimin e dëmit do ta realizoj nga Kompania e Sigurimeve.

E dëmtuara-E.M. në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari deklaroi: I propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë nga djali im sepse aty kemi mundur të vdesim të gjithë, ka qenë e shkruar që të vdes vajza ime Fatmirja dhe lus gjykatën që mos ta dënoj L. sepse na mban të gjithëve dhe jetojmë në kushte shumë të vështira ekonomike, asnjë nuk jemi mirë me shëndet, sa i përket dëmit kompensimin e marrim nga Kompania e Sigurimeve.

Prokurorja e shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë sepse i njejtë pranim u bë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe në pajtim me dispozitat e KPPRK-së dhe i propozoj gjykatës që me rastin e shqyrtimit të dënimit pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, të dëmtuarëve të lartcekur dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së ka vazhduar me shqyrtimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të të akuzuarit, përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës Rrezikim i Trafikut Publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.8 par.6 dhe par.1 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penal-juridik është fajtor.

Gjykata gjatë procedurës penale ka gjetur se i akuzuari është penalisht përgjegjës dhe e ka shpallur fajtor mirëpo e ka liruar nga dënimi në mbështetje të nenit 77 dhe 78 të KPRK-së, sepse vepra penale e cila i ngarkohet të akuzuarit është kryer nga Pakujdesia, nga shkaktimi i aksidentit ka mbetur e vdekur motra e të akuzuarit- e ndjera F.B. ndërsa lëndime trupore kanë pësuar nëna, bashkëshortja, dhëndrri, nipi dhe mbesa e të akuzuarit dhe se këto pasoja me ndikim afatgjatë e kanë goditur kryerësin aq shumë, andaj duke u bazuar në këto fakte dhe rrethana sipas bindjes së gjykatës shqiptimi i ndonjë dënimi do të jetë tërësisht i panevojshëm dhe e humbë çdo kuptim për realizimin e qëllimit të tij.

Duke u bazuar në nenin 453 par.4 të KPPRK-së, gjykata e liron të akuzuarin nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale ngase obligimi në pagesën e tyre do ta rrezikonte gjendjen materiale të akuzuarit dhe personave që është i detyruar ti mbështes financiarisht.

Vendimi mbi udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizim të kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marr në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË,
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal
P.nr.13/2019 me dt.28.02.2019

Sekretarja juridike
Fatmire Podvorica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Minir Hoti

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimet të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate